



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENSIA SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE  
SEKTORI QENEVE PA PRONAR

Nr. 22/1 Prot

Elbasan, më 16.01. 2024

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Për dijeni;** KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në vijim të shkresës suaj Nr.Prot 70/1 më Dt. 12.01.2024 mbi kërkesën e dërguar nga znj. Pranvera Nallbati me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Nisur nga kërkesa për informacionë nga Znj. Pranvera Nallbati mbi punën e kryer në qendrën (strehën) e kafshëve të rrugës në Bashkinë Elbasan. Duke filluar nga muaj Janar 2016 – Dhjetor 2022 në Bashkinë Elbasan është krijuar një sektorë për kapjen, grumbullimin, strehimin, vaksinimin, hehelmitizimin dhe matrikullimin e qenëve të rrugës pa pronar. Nga muaj Janar 2016 – Nëntor 2018 në këtë sektorë kanë shërbyer dy punëtorë dhe një specialistë veteriner. Punëtorët i largononin kafshët nga qendra e qyteteve, për në periferi, më sakte drejt landëfilleve. Veterineri më tepër merrej me studimin dhe mjekimin e qenëve të sëmurë. Proces pune ishte edhe largimi i kafshëve të dëmtuar në qendrat e banuara dhe groposja e këtyre karkasave në varrezat e kafshëve të caktuara nga Bashkia Elbasan.

Sterilizimet, Vaksinimet, dehelmintizimi dhe matrikullimi ka filluar rregullisht nga muaj Janar 2019, gjë e cila vazhdon dhe sot.

Gjatë vitit 2019 në strehën e qenëve të rrugs janë sterilizuar Në këtë territor nndhe matrikulluar 130 qenë të gjinisë femërore dhe mashkullore.

Gjatë vitit 2020 në këtë qendër janë ushëyer, sterilizua, vaksinuar dhe matrikulluar rreth 80 qenë.

Gjatë vitit 2021 në qendrën e strehimit janë kryer shërbime në 93 qenë të gjinisë femërore dhe mashkullore.

Gjatë vitit 2022 deri në muaj korrik janë kapur dhe strelizuar, vaksinuar dhe matrikulluar 52 qenë të gjinisë femërore dhe mashkullore.

Në muajn Korrik 2022 në sektorin e qenëve pa pronar në Bashkin Elbasan solli edhe 4 mjek-veteriner, të cilët morën edhe përgjegjësinë për të kryer këto procese pune. Gjatë periudhës Gusht 2022 – Nëntor 2023, umë i quajturi Velo Merkaj u emërova si specialist terreni për qentë pa pronar. Në detyrën si specialist unë u mora me numërimin e qenëve pa pronar që ndodhen në territorin e Bashkisë Elbasan.

në këtë territor ndodheshin rreth 250 qenë pa prona.

Duke filluar nga 1 Dhjetori 2023 e deri më sot, umë i nënshkruari Velo Merkaj ja, emëruar në pozicionin e përgjegjesit si dhe specialist veteriner. Në strukturën time kam të punësuar 4 punëtor dhe unë si veteriner. Megjithëse ky si sektor është shumë i vështirë dhe me shpenzime të shumta, ne vazhdojmë punën për kapjen , trajtimin, sterilizimin dhe vaksinimin e tyre. Për sa i përket kushteve të punës ka nevojë për përmirësime , kemi nevojë për shiringa – neuroparalizë që shërbejnë për kapjen e qenëve. Në strehën po hospitalizohen rreth 30 – 35 qenë të cilët qëndrojnë rreth 2 javë tek streha. Pasi i sterilizohen, matrikullohen dhe vaksinohen këto qenë lëshohen në habitatin e tyre.

Për sa i përket ankesave nga ana e qytetarëve veprohet si më poshtë:

Kontaktohet qytetari që ka bërë ankesën për ta specifikuar më mirë informacionin dhe pasi identifikohet qeni problematik shkon grupi i punës për të vijuar me kapjen e tij. Qeni mbasi kapet dërgohet në strehën e Bashkisë dhe i nënshtrohet procesit të punës. Ndërkohë qytetarit i kthehet përgjigje në mënyrë zyrtare me shkresë.

Për sa i përket projekt buxhetit për vitin 2024 pranë sektorit të qenëve pa prona janë kërkuar rreth 3,000,000 lekë për të mbuluar të gjitha nevojat e këtij sektori.

Për informacion më të zgjeruar dhe konkret të interesuarit mund të drejtohen pranë strehës që ne posedojmë.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**DR/ DREJTORIE**

Shefqet Arapi

